



RREGULLORJA MBI PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË (ZRRË)

Kjo rregullore rregullon përdorimin e të gjitha automjeteve të ZRRË-së pavarësisht a janë financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nga buxheti i ZRRË-së apo nga donacionet e organizatave të ndryshme.

Rregullorja është e ndarë në seksione ku përshkruhet përdorimi i automjeteve, përvoja në vozitje, mirëmbajtja, raportimi i aksidenteve, këshilla për vozitje dhe të sigurisë, dhe formulari mostër që plotësohet kur përdoren automjetet e ZRRË-së.

Në rast se ndonjë anëtar i stafit nuk u bindet dispozitave të kësaj rregulloreje, ZRRË-ja mban të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore.

PËRDORIMI I AUTORIZUAR I AUTOMJETEVE TË ZRRË-SË

1. Pjesa e përgjithshme

1.1 Automjetet e ZRRË-së do të shfrytëzohen për kryerjen e detyrave zyrtare.

1.2. Anëtari i stafit do ta shfrytëzojë automjetin në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt, në përshtatje me Rregulloren e tanishme të ZRRË-së.

1.3. Anëtari i stafit që ka nevojë të shfrytëzojë automjetin për nevoja zyrtare do të plotësojë formularin dhe do ta dorëzojë në zyrën e administratës. Pas përdorimit të automjetit çelësat do të kthehen në zyrën e administratës. Pas mbarimit të orarit të punës dhe kur zyra e administratës mbyllet, çelësat do të dorëzohen të nesërmen dhe atë sa më parë që të jetë e mundur.

1.4. Për shfrytëzimin e automjetit jashtë Kosovës gjithmonë do të nënshkruhet edhe kërkesa për transport, e bashkangjitur në këtë rregullore.

1.5. Vozitja e automjetit jashtë detyrës mund të lejohet me paraqitjen e kërkesës në administratë dhe aprovimin nga Kryesuesi i ZRRË-së. Duhet të plotësohet formulari i Fletë Udhëtimit dhe karburanti të paguhet nga personi dhe jo të ngarkohet ZRRË-ja me të.

1.6. Në mënyrë të veçantë, neni 1.5 nuk do të aplikohet për anëtarin e stafit nëse përdorimi i automjetit jashtë detyrës është përfshirë në kontratën e nënshkruar me ZRRË-në si dhe për anëtarët e Bordit të ZRRË-së në pajtim me nenin 4.

1.7. Duke iu referuar nenit 1.4 në rast dëmtimi apo humbjeje derisa anëtari i stafit e ka në përgjegjësi automjetin dhe nëse dëshmohet nga autoritetet lokale se ka dëshmi fajësie, atëherë anëtari i stafit duhet ti paguajë ZRrE-së shumën prej 400 €, e cila shumë është mbi shumën e polisës së sigurimit të ZRrE-së.

2. Kualifikimi për vozitje

Asnjë personi nuk do t'i lejohet përdorimi i automjeteve të ZRrE-së nëse nuk janë të pajisur me patent-shoferi valid dhe nëse nuk është anëtar i stafit të ZRrE-së.

3. Kufizimet e shpejtësisë

Kufizimet e shpejtësisë, të përcaktuara nga autoritetet lokale, duhet zbatuar gjithnjë dhe në çdo kohë.

4. Personeli i autorizuar për përdorimin e automjeteve të ZRrE-së jashtë detyrës

Automjetet i janë dhënë ZRrE-së për të siguruar transport adekuat gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Anëtarët e Bordit lejohen të përdorin automjetet edhe kur janë jashtë detyrës.

5. Transportimi i personave që nuk janë anëtarë të stafit të ZRrE-së

5.1. Nëse automjetet e ZRrE-së janë përdorur për transportimin e personave që nuk janë anëtarë të stafit të ZRrE-së, kjo mund të krijojë përgjegjësi financiare për ZRrE-në në rast të kërkesave për dëmshpërblim lidhur me humbjen, dëmin, lëndimet apo vdekjen. Prandaj, që më parë nga udhëtari do të kërkohej që të nënshkruajë formularin e përgjithshëm për lirim nga përgjegjësia, me të cilin ZRrE-ja lirohet nga përgjegjësia. Si shtesë, do të dorëzohet në zyrën e administratës edhe një formular “Kërkesë për transport” në të cilin specifikohet emri, nacionaliteti, marrëdhënia me ZRrE-në dhe numri i pasaportës për aprovim paraprak të tij/saj.

5.2. Vozitësi, i cili, përkundër udhëzimeve, transporton personin e pa-autorizuar (personin i cili nuk gjendet në listën e personave të autorizuar për të udhëtuar me ZRrE-në), përgjegjësia në rast aksidenti, lëndimi apo vdekjeje bie mbi udhëtarët e tij/saj.

6. Kontrolli i mirëmbajtjes dhe sigurisë për automjetet e ZRrE-së

6.1. Kontrollimi bazë i çdo automjeti të ZRrE-së duhet të ushtrohet përmes:

- (a) Plotësimi të Kërkesës për Transport, të nënshkruar si duhet nga zyra e administratës;
- (b) Plotësimi të Kërkesës Formale për Transport me automjetet, nënshkruar si duhet nga zyra e administratës;
- (c) Plotësimi i Fletë Udhëtimit për secilin automjet duhet dorëzuar zyrës së administratës çdo muaj, më së shumti tri ditë pune para përfundimit të muajit;
- (d) Nëse automjeti i ZRrE-së është përdorur jashtë Kosovës, sigurimi për automjet bashkë me fletë udhëtimit duhet dorëzuar në zyrën e administratës. Nëse sigurimin e automjetit

e ka paguar anëtari i stafit me shpenzimet e veta, kjo shume do t'i kompensohet pasi ai ta paraqesë origjinalin e fletë sigurimit.

6.2. “Raporti i udhëtimit me automjet”, i quajtur edhe “fletë udhëtimi”, shërben edhe si autorizim për vozitje të automjetit të ZRrE-së. Vozitësi nuk mund të drejtojë automjetin nëse nuk e ka plotësuar fletë udhëtimit, si dhe personeli që është përgjegjës për drejtimin e automjetit duhet të sigurojë që:

- (a) Karburanti, vaji dhe lubrifikantët të shënuar për secilin automjet janë futur në fletë udhëtimit relevant;
- (b) Të gjitha udhëtimet e bëra janë përshkruar në fletë udhëtim, me vërejtje të veçantë në kilometrazhin e realizuar nga fillimi e deri në mbarim të udhëtimit;
- (c) Çdo defekt i automjetit është shënuar në fletë udhëtim;
- (d) Varësisht nga vjetërsia, automjeti duhet dërguar për servisim tek mekaniku i kontraktuar nga ZRrE-ja pas çdo 5000 – 10.000 km të kaluar, e i cili do të përgatisë raportin e kontrollit të automjetit, dhe i cili do të ruhet në dosjen e zyrës së administratës.
- (e) Vozitësi do të informojë zyrën e administratës kur e dërgon automjetin për servisim, riparim apo mirëmbajtje të zakonshme si dhe pasi ta marrë automjetin nga mekaniku.
- (f) Asnjë automjet nuk do të drejtohet nëse ai nuk është në gjendje të sigurt mekanike për vozitje.
- (g) Çdo vozitës duhet të mbajë gjësendet (mjetet) elementare në automjet. Një kopje e këtyre mjeteve duhet dhënë zyrës së administratës dhe tjetra duhet mbajtur në automjet.

6.3. Kontrolli ditor para nisjes:

Niveli i ujit ftohës;
Niveli i fluidit të frenave;
Treguesit në tabelën e instrumenteve, posaçërisht treguesi i karburantit;
Dritat e përparme dhe të pasme si dhe treguesit;
Veglat e makinës dhe pajisjet ndihmëse;
Boria;
Kilometrazhi për mirëmbajtjen e ardhshme; dhe
Kontrolli i jashtëm të makinës (gomat, dëmtimet në karroseri, rrjedhjet eventuale, etj.)

7. Kontrollimi ditor gjatë përdorimit:

7.1. Drejtimi me timon dhe frenat

7.2. Mirëmbajtja nga ana e vozitësit është aspekti më i rëndësishëm i sistemit të mirëmbajtjes së mirë, në mënyrë që të parandalohen shkatërrimet dhe defektet e vogla mekanike duhet të raportohen para se ato të bëhen të mëdha. Nëse automjeti ka nevojë për servisim, personi që e përdor atë duhet të kontaktojë me zyrën e administratës.

7.3. Vozitësit janë përgjegjës për sigurinë e automjetit dhe përmbytjes së tij. Automjeti i tyre duhet lënë pa mbikëqyrje vetëm nëse është i parkuar në vend të sigurt dhe kjo është bëhet kur është vërtetuar se automjeti është siguruar (mbyllja e deryeve, dritareve, mekanizmi

për mbylljen e timonit ose ndërruesit të shpejtësive). Nuk duhet lënë në makinë gjëra që bien në sy. Është përgjegjësi e vozitësit që të sigurohet se automjeti i tij është parkuar drejt dhe i siguruar gjithë kohën nga roja e parkingut kundër vjedhësve, aksidenteve, vandalizmit apo humbjeve tjera.

7.4.Pos simbolit të aprovuar, automjetet e ZRrE-së nuk do të mbajnë asnjë shenjë tjetër dalluese, simbol apo flamuj kombëtar.

8. Vënia e rripit të sigurisë

Çdo bartës i automjetit duhet të vendosin rripin e sigurisë gjatë gjithë kohës sa ai udhëton me automjetin e ZRrE-së. Është përgjegjësi e vozitësit që të sigurojë që edhe udhëtari/ët e tij të vendosin rripin e sigurisë.

9. Raportimi, shqyrtimi dhe veprimi në rast aksidenti

9.1.Kurdo që një automjet i ZRrE-së është i përfshirë në ndonjë aksident, vozitësi duhet të ndërmarrë këto veprime:

- (a) Të ndalë automjetin dhe të qëndrojë në vendin e ngjarjes përderisa veprimet që cekën më poshtë të mos kryhen dhe siguria e tij/saj të mos jetë e rrezikuar. Vozitësi duhet të kontaktojë policinë dhe të marrë raportin nga policia.
- (b) Të jap ndihmën e parë ndonjërit nga të lënduarit nëse ai/ajo ka mundësi ta japë.
- (c) “Raporti mbi shkatërrimin/dëmtimin e automjetit” që mbahet në dosjen e fletë udhëtimit duhet të plotësohet në vendin e ngjarjes së fatkeqësisë dhe të dërgohet në zyrën e administratës brenda 24 orëve, ndërsa kopja e tij t’i dërgohet kompanisë së sigurimit të automjetit brenda 48 orëve.
- (d) Në rast të lëndimit apo shkakimit të dëmit në pasuri palës së tretë, pos procedurës së përcaktuar më lart, vozitësi duhet të njoftojë policinë lokale ose drejtpërdrejt ose përmes ZRrE-së.
- (e) Kur policia nuk është prezent, vozitësi i automjetit të ZRrE-së duhet të marrë shënimet e vozitësit të automjetit tjetër ose pronarit të pasurisë tjetër ose personit/ve që janë përfshirë në fatkeqësi, dhe personit/ve të përfshirë në fatkeqësi si emrin, numrin e letërnjoftimit dhe numrin e regjistrimit të automjetit të ZRrE-së.
- (f) Në këmbim të kësaj, siguron informata ekuivalente nga palët tjera si dhe emrin, numrin dhe stacionin policor të zyrtarit policor që bën hulumtimin e rastit.
- (g) Pavarësisht nga informata referuar asaj që mu tha më lart, as vozitësi e as ZRrE-ja nuk duhet të marrin mbi vete asnjë përgjegjësi. Çdo deklaratë nga vozitësi apo ndonjë person tjetër që udhëton me automjetin e ZRrE-së duhet t’i jepet vetëm personit të autorizuar të

policisë lokale. Nëse kërkohet apo dorëzohet deklaratë më shkrim, vozitësi duhet të shpjegojë se autoritetet e ZRrE-së janë kompetente të merren me situata të tilla.

- (h) Siguron automjetin dhe përmbajtjen e tij kundër vjedhjeve dhe siguron që automjetet e përfshira në fatkeqësi nuk kanë lëvizur nga vendi i ngjarjes derisa të vijë policia/personi i autorizuar për hulumtim, përveç nëse automjeti paraqet rrezik për jetën e njerëzve/ose fatkeqësi të rëndë trafiku.
- (i) Pavarësisht nga serioziteti i fatkeqësisë, të gjitha aksidentet duhet raportuar zyrës së administratës apo Bordit të ZRrE-së sa më parë që të jetë e mundur.
- (j) Nëse automjeti është plotësisht i bllokuar, duhet kërkuar ndihmë nga administrata dhe fatura duhet dorëzuar në zyrën e administratës për kthimin e parave. Automjetet e përfshira në aksidente nuk duhet lënë pa mbikëqyrje në vendin e ngjarjes.

9.2. Varësisht nga faktorët e ndryshëm, Bordi i ZRrE-së do të rishikojë aksidentin e automjeteve për të përcaktuar, pos tjerash, a duhet, dhe gjer në cilën masë, vozitësi i përfshirë në aksident duhet të mbahet përgjegjës personalisht dhe financiarisht për ndonjë shpenzim apo humbje shkaktuar nga ZRrE-ja si pasojë e fatkeqësisë. Bazuar në këtë përcaktim, një shumë e duhur pagese mund të ndalet nga paga për të mundësuar veprimin kthyes pasues.

10. Vozitja nën ndikimin e alkoholit

Vozitja nën ndikimin e alkoholit rreptësisht është e ndaluar

11. Aplikueshmëria

Kjo rregullore është e aplikueshme nga data e aprovimit të saj.

Kjo rregullore është nxjerrë në tri gjuhë, në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rast të ndonjë paqartësie, mbetet versioni në gjuhën angleze.

Datë: _____

Bordi i ZRrE-së:

Nick Frydas _____

Merita Kostari _____

Naim Bejtullahu _____

Theranda Beqiri _____

Nysret Avdiu _____